

ABSTRAKT

Në Kosovë qeverisja korporative konsiderohet si një shtyllë bazike për të siguruar një stabilitet financiar. Veç kësaj ndikon edhe në rritjen e besueshmërisë së institucioneve financiare nga shoqëria në përgjithësi, duke iu mundësuar marrjen e kredive apo afatizimin e parave, po ashtu, edhe në investimet e të huajve në Kosovë, duke ofruar siguri si juridike ashtu edhe financiare.

Qeverisja korporative është sistemi me anë të të cilit drejtohen dhe kontrollohen kompanitë, ky është ndër definicionet më klasike të qeverisjes korporative. Një përkufizim më i përdorur dhe përkufizim në aspekt ekonomik thotë se: “Qeverisja korporative ballafaqohet me mënyrat në të cilat furnizuesit e financave të korporatave sigurojnë veten e tyre për të përfituar nga investimi i tyre”. Në të drejtën korporative, sa i përket qeverisjes së korporatave fokusi është tek aksionarët si anëtarë të shoqërisë. Interesat e palëve të tjera të interesuara si kreditorët, debitorët si dhe qeveria, janë lënë tek pjesët e tjera të ligjit. Në sektorin bankar, qeverisjen korporative mund t’u përkufizojmë si një sistem ku performanca e një banke udhëheqet dhe mbikëqyret, për të realizuar kërkesat dhe qëllimet e asaj banke. Qeverisja korporative në sektorin bankar udhëheqet nga një bord drejtues, i cili ka një gamë të gjerë për realizimin e përgjegjësive, të tilla si: vendosja e një sistemi efektiv kontrolli të mbështetur nga auditimi i brendshëm i pavarur dhe i kualifikuar, ngritja e një sistemi vlerash të korporatës, lehtësimin e menaxhimit transparent dhe përdorimin e sistemeve të kompensimit që ofrojnë stimuj për arritjen e objektivave të bankave. Dështimet e qeverisjes janë ngushtë të lidhura me dështimet thelbësore të tregut. Ndërsa hulumtimet aktuale sugjerojnë se, informacioni është një pjesë integrale e qeverisjes së institucioneve financiare dhe adresimit të rrezikut sistemik në sistemin financiar, kërkime të mëtejshme janë të nevojshme për të kuptuar kompleksitetet e prodhimit, përdorimit dhe cilësisë së informacionit në tregjet financiare. E veçanta e qeverisjes korporative në banka është se ka mendime të ndryshme, duke filluar nga ajo se disa prej tyre mendojnë se bankat nuk janë thelbësisht të ndryshme nga kompanitë e tjera në lidhje me qeverisje korporative, edhe pse ka dallime të rëndësishme të nivelit dhe pasojat e saj ndikojnë në tërë ekonominë.

Fjalët kyçe: Qeverisja Korporative në Kosovë, Përmirësimi i Qeverisjes Korporative, Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Korniza Ligjore dhe Rregullative.

